



## Pasqyrim mujor nga ndjekja e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore – maj 2017

### I GJYQËSORI

#### Pavarësia

##### **Gjykata e Lartë vazhdon të diskutojë mbi përdorimin e materiale të përgjuara**

Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë vazhdoi me Seancën e Përgjithshme, në të cilën u shqyrtua referati në lidhje me çështjen juridike “A mund të përdoren dëshmitë të cilat janë marrë në mënyrë joligjore si dëshmi në procedurë gjyqësore”, d.m.th. diskutoi për përdorimin e materialeve të përgjuara në procedurë dëshmuese.

Në vazhdimin e Seancës së përgjithshme merrnin pjesë znj. Mirjana L Lazarova Trajkovska, ish-gjykatëse në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut, e cila i njohu gjykatësit me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe u është përgjigjur pyetjeve të parashtruara. Vendimi nuk është marrë, kurse vazhdimi i seancës është shtyrë në afat të papërcaktuar.<sup>1</sup>

##### **Paraburgim dhe masa për kujdesi për pjesëmarrësit në dhunën në Kuvend**

Me propozim të Prokurorisë Themelore Publike, gjykatësi në procedurë paraprake i Gjykatës Themelore Shkup 1 caktoi masë paraburgim për dy persona, kurse për dy persona të tjerë caktoi masë për kujdes. Të dyshuarit ngarkohen me veprat penale Pjesëmarrje në turmë e cila do të kryejë vepër penale prej nenit 385 të KP-së dhe Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm prej nenit 288 të KP-së.<sup>2</sup>

##### **PTHP për krim të organizuar dhe korrupsion përfshihet në hetimin për të përfshirët në dhunën në Kuvend**

PTHP-ja informoi se pas shqyrtimit të dëshmive materiale ka vendosur që në hetim është e nevojshme të përfshihet edhe Njësia për krim të organizuar dhe korrupsion sepse një pjesë e veprimeve të kryera nga personat e involvuar në këtë ngjarje kanë qenë në kompetencë vendore dhe sendore të kësaj prokurorie.<sup>3</sup>

Nga prokuroria informojnë se bëhet fjalë për gërshetim të veprimeve të inkriminuara që nënkuptojnë realizim të ekzistencën ligjore të një numri të madh veprash penale të cilat nuk mund të përcaktohen vetëm si delikt i masës, dhe as si vepra konkrete penale të kryerësve që dalin nga kjo masë.

<sup>1</sup> <http://alturl.com/8rrgu>

<sup>2</sup> <http://alturl.com/mhjb2>

<sup>3</sup> <http://jorm.gov.mk/?p=4067>





## Dënime me kusht për nëntë persona pjesëmarrës në dhunën në Kuvend

PTHP Shkup dorëzoi Propozim akuzues kundër nëntë personave pjesëmarrës në trazirat në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Të akuzuarit ngarkohen se kanë kryer veprën penale Pjesëmarrje në turmë që do të ndalojë personin zyrtar në kryerjen e veprimeve zyrtare prej nenit 381 paragrafi 1 i Kodit Penal.

Më 23 maj, gjatë seancës kryesore para Gjykatës Themelore Shkup 1 të nëntë të akuzuarit e pranuan veprën pas kësaj Gjykata menjëherë shqiptoi dënime me kusht me burg. Asnjë prej të akuzuarve nuk ka marrë dënim efektiv me burg edhe pse një pjesë e tyre gjenden në evidencën penale për vepra penale të kryera më parë.

Pas ngjarjeve në Kuvend, Komiteti i Helsinkit përgatiti raport special në të cili identifikoi elementë të përmbushur për 28 vepra penale nga Kodi Penal.<sup>4</sup> Të njëjtin e ka dorëzuar në Prokurorinë Themelore Publike dhe në MPB. Prokuroria në procedurat e deritanishme ka nxjerrë kualifikime juridike vetëm për 5 vepra penale. Veprimin e tillë e ka shpjegua me pohimin se kualifikimin juridik për vepër penale të kryer jep prokurori publik i cili gjatë marrjes së vendimit udhëhiqet nga dëshmitë që janë mbledhur deri në atë moment që do të thotë nëse gjenden dëshmi të reja shtesë të cilat dëshmojnë se një person i caktuar ka kryer një vepër tjetër penale, prokurori publik gjatë të gjithë procedurës mund të kryejë rikualifikim apo personin ta ndjekë edhe për vepra të tjera penale.<sup>5</sup>

## Procedurë hetimore për përpjekjen për vrasje të deputetit Ziadin Sela

Prokuroria Themelore Publike informoi se fillon procedurën hetimore kundër dy personave të cilët së bashku me persona të tjerë janë të dyshuar se ditën e dhunës në Kuvend në ndërtesën e Kuvendit kanë kryer tentim për vrasje të deputetit Ziadin Sela.<sup>6</sup>

Prokurori publik kompetent ka lëshuar Urdhrin për zbatim të procedurës hetimore kundër dy personave për veprën penale të dhënë më sipër. Prokuroria Publike konsideron se kundër të dyshuarve është e domosdoshme të shqiptohet masa për sigurimin e tyre, prandaj prokurori publik ka dorëzuar te gjykatës në procedurë paraprake Propozim për përcaktim të masës paraburgim. Kundër dy të akuzuarve është shqiptuar masa paraburgim prej 30 ditësh.

## Procedurë hetimore për personin i cili vendosi pajisje eksplozive në Kuvend

Prokuroria Themelore Publike informoi se ka ngritur procedurë kundër një personi sepse ekzistojnë baza dyshimi për vepra penale të kryera Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 288 dhe Përpunim, mbajtje dhe tregti pa leje me armë apo me materie shpërthyes nga neni 396 i Kodit Penal.<sup>7</sup>

<sup>4</sup>[http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor\\_assets/documents/2282/Poseben\\_izvestaj\\_Sobranie\\_27\\_04\\_17.pdf](http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2282/Poseben_izvestaj_Sobranie_27_04_17.pdf)

<sup>5</sup><http://jorm.gov.mk/?p=4028>

<sup>6</sup><http://jorm.gov.mk/?p=4044>





Duke vlerësuar se janë përmbushur bazat ligjore, prokurori kompetent publik ka dorëzuar te gjykatësi në procedurë paraprake në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup kërkesë për përcaktim të masës paraburgim për të dyshuarin. Propozimi i prokurorisë është pranuar nga gjykata e cila me Vendim personit të dyshuar i ka përcaktuar paraburgim në periudhë prej 30 ditësh.

## Paanësia

### **Gjykata e lartë e ndërpreu paraburgimin për Sead Koçanin, gjykatësi në procedurë paraprake pranoi garanci për mbrojtje në liri**

Lënda e Sead Koçanit u kthye në fillim, te gjykatësi për procedurë paraprake që të veprohet dhe merret vendim përsëri për shkak të shkeljeve themelore të dispozitave të LPP-së. Këshilli Penal me përbërje: gjykatësja Monika Bahçovanovska – kryetare e këshillit dhe gjykatëset Lubinka Basheska dhe Vesna Kostova-Spaseska – anëtarë të këshillit, e mori këtë vendim duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Publike Speciale.<sup>8</sup>

Paraprakisht nëpërmjet lajmërimit me shkrim Gjykata e Lartë pohoi se këshilli prej pesë anëtarësh i ka ndërprerë vendimet e këshillit penal të Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe Këshillit Penal të Gjykatës së Apelit - Shkup për masën paraburgim të Sead Koçanit. Në të thuhet se vendimi vijon për shkak se gjykatat më të ulëta i kanë shkelur ligjet kur Koçanin i kanë përcaktuar paraburgim.<sup>9</sup>

Vendimin e ka marrë këshilli penal prej pesë anëtarësh kryetar i të cilit është Jovo Vangelovski. Ky është marrë pas kërkesës të dorëzuar për mbrojtjen e ligjshmërisë nga prokurori publik Marko Zverlevski.

Gjykatësi në procedurë paraprake e ka pranuar propozimin e mbrojtësit të të dyshuarit dhe ka marrë vendim që z. Koçan t'i përcaktohet një garanci e caktuar në të holla me shumë prej 875.298,56 euro, dhe t'i merret pasaporta dhe t'i jepet obligimi që të paraqitet një herë në javë në gjykatë. Propozimi për përcaktim të masës paraburgim sepse i dyshuari do të ndikojë mbi dëshmitarët apo se vepra do të përsëritet është hedhur poshtë si i pabazë.<sup>10</sup>

Vendimin e tillë Gjykata e ka marrë për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore të Koçanit (i cili ka dorëzuar vërtetim mjekësor se i është bërë intervenim kirurgjik – implantim i stentit në zemër), kurse si të pabazë e refuzoi propozimin e Prokurorisë Speciale Publike që t'i përcaktohet paraburgim biznesmenit për shkak të rrezikut të ndikojë mbi dëshmitarët apo ta përsërisë veprën.

### **Janë refuzuar kërkesat e PSP-së në Gjykatë që të ngrijë një pjesë të pronës së partisë VMRO-DPMNE**

<sup>7</sup> <http://jorm.gov.mk/?p=4053>

<sup>8</sup> <http://alturl.com/dstt4>

<sup>9</sup> <http://alturl.com/py3mg>

<sup>10</sup> <http://alturl.com/swpce>





Gjykata Penale nuk ka pranuar asnjë kërkesë të Prokurorisë Speciale Publike (PSP) për ngrirje të pronës së VMRO-DPMNE-së për rastin “Talir”. Janë refuzuar të 12 kërkesat për ngrirje të pronës, midis të cilave edhe ajo për selinë e partisë.<sup>11</sup>

Sipas procedurës parahetimore të PSP-së, nga viti 2009 deri në vitin 2015, të dyshuarit nga udhëheqja e partisë kanë pranuar mjete joligjore për financim të partisë në vlerë prej 4,9 milionë eurosh. Këto para, në vend që të kthehen në buxhet, siç parashikon ligji, janë përdorur për financim joligjor të partisë.

Gjykatës të procedurës paraprake së pari kanë shprehur mospajtim për ngrirje të pronës, kurse mandej gjykatësit e Këshillave penale të Njesisë për Krim të organizuar dhe korpusin e kanë pranuar mospajtimin e tyre. PSP-ja ka korigjuar një pjesë të rekomandimeve të Gjykatës Penale dhe kërkoj përsëri ngrirje të pronës së VMRO-DPMNE-së, thuhet në shpalljen e PSP-së.<sup>12</sup> Këtë radhë, prokuroria kërkoj ngrirje vetëm të një objekti – selia e partisë.

Gjykata penale, për herë të dytë, refuzoi të ngrijë shtatëkatëshin e partisë në qendër të qytetit. Tri gjykatës, Goran Boshevski, Vera Petkovska dhe Lenka Davitkovska kanë vlerësuar se nuk ka dëshmi dhe elementë të veprës penale se selia e partisë është ndërtuar në mënyrë joligjore.<sup>13</sup>

Për këto vendime PSP-ja nuk ka të drejtë ankese.

## II. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

### Tri hetime të reja të Prokurorisë Publike Speciale

Prokuroria Speciale Publike në pres-konferencë shpalli hapjen e tri hetimeve të reja: “Lëndina”, “Trajektorja” dhe “Talir”.<sup>14</sup>

Prokurorja speciale publike, Katica Janeva, theksoi se bëhet fjalë për dy hetime financiare, kurse njëri lidhet me parregullsi në procedurë gjatë ndërtimit.

“Lëndina” – Prokuroria e hapi këtë hetim si rezultat i bisedave të përgjuara, që nuk janë shpallur në publik, dhe përfshijnë dyshim të bazuar për kryerje të veprimeve penale-juridike të tri personave gjatë ndërtimit të tri shtëpive për fundjavë në Komunën e Zelenikovës, pa pasur të drejtë për ndërtim të tillë. përkatësisht ndërtim pa leje për ndërtim. Sipas dëshmive të mbledhura, midis të cilave edhe xhirime me satelit, ekspertimit të tyre, si dhe të dokumentacioneve të tjera, këto tri shtëpi për fundjavë kanë filluar të ndërtohen në vitin 2011, kurse leje ndërtimi nga komuna është marrë në vitin 2013, kur kanë qenë të

<sup>11</sup> <http://alturl.com/snfv2>

<sup>12</sup> <http://alturl.com/6ov3o>

<sup>13</sup> <http://alturl.com/6i6s7>

<sup>14</sup> <http://alturl.com/hj564>





përfunduara. Ligji për ndërtim parashikon renditje të kundërt, përkatësisht së pari miratim i plotfuqishëm për ndërtim, pastaj fillim me ndërtimin, kurse jashtë këtij rendi për veprimet e tilla jashtëligjore janë parashikuar edhe të dënueshme me veprën përkatëse penale, ndërtim pa leje nga neni 244 a paragrafi 1 i KP, për të cilin është hapur ky hetim.

**“Trajektorja”** – Hetimi i dytë është hapur kundër katër personave zyrtarë – ish-funksionarë të lartë qeveritarë, për të cilët ekziston dyshim i bazuar se në gjysmën e dytë të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013 kanë ndërmarrë më tepër veprime me të cilat në procedurën për përzgjedhje të kompanive kontraktuese për ndërtim të akseve të autostradave Miladinovci – Shtip dhe Kërçovë – Ohër i kanë shfrytëzuar dhe tejkalar autorizimet e veta zyrtare dhe e kanë Dëmtuar Buxhtin e RM-së në shumë prej minimum 155.117.172 euro dhe për të njëjtën shumë kompanisë-kontraktuese i kanë mundësuar të fitojë dobi pronësore.

**“Talir”** – Hetimi i fundit i cili është prezantuar lidhet me financimin e paligjshëm të partisë politike VMRO DPMNE. Sipas PSP-së ekziston dyshim i bazuar se dhe pse i dyshuari i parë si kryetar i partisë politike i njihte kufizimet ligjore, megjithatë ai në periudhën nga viti 2009 deri në fund të vitit 2015 ka mundësuar financimin e partisë në kundërshtim me dispozitat ligjore, gjatë kësaj motivet e veprimit të të dyshuarit të parë kanë qenë vetëm prej natyrës personale dhe lidhen me përforsimin e pozitës dhe fuqisë politike të tij në parti dhe në shtet dhe sigurim të kontrollit të tërësishëm mbi partinë politike. Gjatë periudhës së dhënë prokuroria pohon se në parti janë futur ilegalisht 4.900.000 euro. Në prezantimin e hetimit prokuroria theksoi se posedon dëshmi materiale në formën e 12 000 transakcioneve bankare dhe janë dëgjuar mbi 260 dëshmitarë.

Njëkohësisht, PSP-ja pohon se ekziston dyshim i bazuar se kjo nuk ka qenë mënyra e vetme e financimit joligjor të partisë politike. Thanë se ekziston dyshim i bazuar se i dyshuari i pari si person përgjegjës në kundërshtim me kufizimet ligjore të parapara në Ligjin për financim të partive politike, ka mundësuar për partinë politike VMRO-DPMNE të sigurohen shërbime nga personi juridik SHN “Beton” ShA Shkup, e cila në kohën e sigurimit të shërbimeve ka bërë marrëveshje për dhënien e furnizimeve publike.

### **Prokuroria Themelore Publike heton pastrim parash nëpërmjet NLB Tutunska banka**

Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit informoi se ka krijuar lëndë kundër një ish-drejtori dhe kundër një drejtori aktual të NLB Tutunska banka, ish-ministri, avokati, noteri dhe personave të tjerë, si dhe kundër një personi nënshtetas i Republikës së Sllovenisë për veprat penale të kryera – Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 dhe Pastrim parash nga neni 273 i Kodit Penal.

Prokuroria informon se ekzistojnë dyshime se në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2017 janë ndërmarrë veprime për themelim të firmave, marrjen e kredive dhe kalimin e mjeteve në të holla në Slloveni dhe në firma austriake, kurse pastaj një pjesë e mjeteve janë investuar në themelimin e firmave të reja dhe blerjen e pasurive të patundshme në rajonin e qytetit të Manastirit.







Në këtë shpallje të prokurorisë qëndron se ka dhënë urdhra për analizë të transaksioneve financiare dhe sigurim të materialit të tërësishëm dëshmuar me natyrë pronësore, financiare dhe drejtuese, me qëllim që të vërtetojë fakte dhe të sigurojë dëshmi.<sup>15</sup>

## PROCEDURA AKTUALE GJYQËSORE

### “Kështjella 2” - K-1905/16

Në seancën e fundit të mbajtur, një nga mbrojtësit e theksoi faktin se PSP-ja i ka marrë dëshmitë në mënyrë të paligjshme dhe njëkohësisht iu drejtua nenit 197 paragrafi 1 i LPP, kështu që nga mbrojtja u kërkua që gjykata t'i refuzojë dëshmitë e deklasifikuar. Megjithatë, nga Prokuroria Speciale Publike thanë se propozimi i tillë është i pabazë, sepse në kompetencë të PTH është të ndjekë kryerës të veprave penale sipas principit të parimit të legalitetit në përputhje me nenin 287 të LPP-së, të njëjtat janë marrë në mënyrë ligjore. Mandej propozimi për veçimin e dëshmimeve për deklasifikim nga listat e lëndës, si dëshmi të marra në mënyrë joligjore, është refuzuar nga gjykata dhe është marrë vendim se dëshmitë e prokurorëve janë marrë në mënyrë ligjore dhe të njëjtat i pranoi dhe do t'i marrë parasysht. Nga prokuroria është propozuar që të dëgjohen edhe dëshmitarë, të cilët nuk ishin të pranishëm në seancë, prandaj duke pasur parasysht mungesën e kushteve për vazhdim të seancës, gjykimi është shtyrë për më 03.05.2017.

### “Dhuna në Kuvend”

Një pjesë e të akuzuarve për trazirat në Kuvendin e M-së, të cilët ngarkohen për kryerjen e veprës penale “Pjesëmarrje në turmë që do të ndalojë person zyrtar në zbatimin e veprimeve zyrtare” sipas nenit 384, paragrafi 1 i KP-së së RM-së, janë nxjerrë para gjykatës dhe të njëjtit, pas parashtimit të përmbajtjes nga prokuroria, dhe në prani të mbrojtësve të vet, e pranuan veprën. Në seancë ishin thirrur dhe personat e dëmtuar zyrtarë/përfaqësues të MPB-së dhe të sigurimit të Kuvendit, prej të cilëve një pjesë paralajmëruan dhe kërkim për zhdëmtim në procedurë të veçantë qytetare, kurse një pjesë vetëm u bashkëngjitën me përndjekjen penale. Të nëntë të akuzuarit morën dënim me kusht, kurse i akuzuari i parë për shkak të ekzistimit të dënimit të mëparshëm ka marrë dënim me burg prej 1 viti e 6 muajsh, i cili nuk do të zbatohet nëse ai nuk kryen vepër të re penale në periudhë prej 5 vjetësh, kurse 8 të akuzuarit e tjerë, morën dënime me kusht në periudhë prej 6 muajsh, të cilat nuk do të zbatohen nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepra të reja penale në periudhë prej 1 viti e 6 muajsh.

### “Lagjja e trimave” - KOK 127/15

Seancat për lëndën KOK nr. 127/15, e njohur në publik si “Lagjja e Trimave” gjatë këtij muaji ishin të hapura për publikun.

<sup>15</sup> <http://jorm.gov.mk/?p=4048>





Në seancën e mbajtur më 05.05.2017 për rastin “Lagjja e trimave” është marrë në pyetje i akuzuari i fundit prej 37 të akuzuarve. Marrja në pyetje e tij është kryer në përputhje me Ligjin për procedurë penale. Në këtë seancë në përputhje me nenin 394 të LPP prokurorët publikë dhe mbrojtja dhanë propozim për plotësim të procedurës dëshmitare. Gjykata i informoi të gjithë të pranishmit de seanca e caktuar për më 09.05.2017 nuk do të mbahet, kurse procedura do të vazhdojë më 11.05.2017.

Seanca e mbajtur më 11.05.2017 për rastin “Lagjja e trimave” nga ora 9.30 deri në orën 11.30 ishte e mbyllur për publikun. Pastaj seanca ishte e hapur për publikun dhe vazhdoi me dorëzimin e propozimeve të mbrojtjes për plotësim të procedurës dëshmitare në përputhje me nenin 394 të LPP-së dhe fjalën e mbrojtësve në këtë procedurë kundër dëshmisë plotësuese të prokurorisë publike. Seanca e ardhshme është caktuar për më 15.05.2017. Dy seancat vijuese janë shtyrë duke pasur parasysh se nevojitej kohë shtesë për të marrë vendim në lidhje me dëshmitë.

Para fillimit të debatit kryesor, më 23.05.2017, mbrojtësit e të akuzuarve kërkuan tërheqjen e këshillit gjyqësor, prokurorëve publikë dhe Kryetarit të Gjykatës së Lartë për shkak të udhëheqjes së anshme dhe joprofesionale të procedurës, që sipas tyre është evidente nga refuzimi i pothuajse të gjitha dëshmive shtesë të propozuara nga mbrojtja. Mbrojtësit ishin të revoltuar dukshëm nga arsyetimi i gjykatës pse pjesa më e madhe e dëshmive dhe dëshmitarëve të propozuar shtesë nga mbrojtja nuk pranohen sepse mbrojtja duhej t’i siguronte në procedurë të mëparshme. Pas këtyre kërkesave për tërheqje, këshilli gjyqësor u tërhoq për këshillim dhe përcaktoi pauzë gjatë së cilës gjykatësit biseduan edhe me prokurorët publikë. Pas përfundimit të pauzës gjykata e ndërpreu procedurën derisa për kërkesën për tërheqje të vendosin organet kompetente.

### **“E majta” - K-986/16**

Duke pasur parasysh ndërprerjen në procedurë e cila ja zgjatur më tepër se 90 ditë. e njëjta filloi nga fillimi. U diskutua dëshmia kontestuese sipas mbrojtjes – ekspertizë e madhësisë së dëmit që është shkaktuar nga dëmtuesi, kurse me shkresë të PP. Gjykatësi theksoi se për madhësinë e kërkesës së dëmtuar do të shprehet gjatë procedurës, kurse ekziston mundësia që për të njëjtën t’i dërgojë edhe në kontest qytetar. Mbrojtja dorëzoi kërkesë për ndërprerje të masave për sigurim të pranisë – paraqitje në gjykatë, PP ra dakord dhe gjykata mori vendim për ndërprerjen e tyre, kurse më pas seanca u shty për më 10.07.2017 në orën 11.

### **DOV nr. 08-12/4 – lëndë para Këshillit Gjyqësor të RM-së**

Bëhet fjalë për lëndë për shkarkim të gjykatësit ish-kryetar i Gjykatës së Apelit në Shkup, Jordan Mitrinovski, i cili ka ngritur procedurë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga e cila është përcaktuar se ekziston shkelje e nenit 6 të GJEDNJ-së. Seanca u shty me kërkesë të avokatëve të ish-gjykatësit Mitrinovski për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore, i cili nuk merrte pjesë në seancën e sotshme. Avokatët kërkuan shtyrje të seancës në një kohë të papërcaktuar.





### III. Тë drejtat themelore

#### Sundimi i drejtësisë

Gjatë muajit maj, fokusi më i rëndësishëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme ishte zbardhja e ngjarjeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të 27 prillit, si dhe sanksionimi i veprave të mundshme penale të kryera dhe të kryerësve të tyre. Në lidhje me ngjarjet në Kuvend, ishte i pranishëm edhe interesi i mediave, i shprehur mirë nëpërmjet emisionit “Kod”<sup>16</sup>, ku janë përfshirë shumë aspekte të atyre ngjarjeve, sidomos të organizatorëve të tyre dhe qëllimin e tyre, kryerësit dhe veprat penale të cilat janë kryer, cilat janë prapaskenat dhe lëshimet e policisë. Por edhe përkrah përpjekjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme, SPB Shkup për të ndërmarrë masa dhe aktivitete konkrete në drejtim të identifikimit të personave pjesëmarrës në këto ngjarje të cilët kanë ndërmarrë veprime që përmbajnë elemente të kryerjes së veprës penale, megjithatë nga gjykata, një pjesë e të akuzuarve (9) janë dënuar me dënime me kusht për veprën për të cilën janë akuzuar – pjesëmarrje në turmë e cila pengon personin zyrtar në kryerjen e obligimit zyrtar.

Por vepra penale për të cilën gjykata ka dhënë dënim me kusht nuk është e vetmja që është kryer më 27 prill, përkundrazi, siç theksoi dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë në Raportin e vet të veçantë për ngjarjet në Kuvend: “Raporti përmban 28 vepra penale gjithsej, për 18 prej të cilave ekzistojnë një numër i madh dëshmish dhe 10 vepra penale për të cilat ekziston dyshim se janë kryer. Kryerësit e mundshëm janë ndarë në katër grupe: 1) organizatorë, 2) kryerës, 3) nëpunës policorë dhe 4) udhëheqësit e nëpunësve policorë. Veprat penale që dalin nga 8 kapituj të Kodit penal, kurse janë kundër: 1) jetës dhe trupit; 2) të drejtave dhe lirive të qytetarëve; 3) pronës; 4) sigurisë; 5) shtetit; 6) obligimit zyrtar; 7) gjyqësorit dhe 8) rendit publik. Roli i organeve gjyqësore është të përcaktojnë se a janë bërë dhe cilat prej veprave penale janë kryer apo ka pasur përpjekje për kryerje të tyre dhe të mos lejojnë kualifikim të gabuar, kolektivizim të përgjegjësisë dhe sanksionin afrofe.”<sup>17</sup>

Më në fund, edhe përkrah këtyre ngjarjeve në Kuvend, më 31 maj u mbajt seanca plenare ku me 62 vota “pro” dhe 44 vota “kundër” dhe 5 vota “abstenim” Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e votoi Qeverinë e re të udhëhequr nga partia politike LSDM, me në krye Zoran Zaev.

#### Avokati i Popullit

Këtë maj është aktualizuar statusi i të a.q. persona fantomë, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë, por pa status juridik të zgjidhur, domethënë, pa asnjë lloj mbrojtjeje dhe garancie për realizimin e të drejtave dhe lirive. Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, rikujtoi se përveç kësaj situatë me një

<sup>16</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=59Q4ehr7Q1E>

<sup>17</sup> <http://mhc.org.mk/analysis/578#.WTa8w2h97IU>







pjesë të romëve në Maqedoni, shtesë edhe mbi 150 refugjatë nga Kosova, tashmë prej 18 vjetësh jetojnë pa status juridik të zgjidhur.

Duke theksuar se mosekzistimi i vullnetit politik shkrihet në masa të cilat nuk prodhojnë veprim juridik efektiv, përkatësisht masa të cilat e çrregullojnë sundimin e të drejtës, Memeti shpjegoi procedurën e cila i vendos këta njerëz në pozitë të vështirë ekzistuese: “Sektori për azil u jep dokument me të cilin personi është në fazë të kthimit të suspenduar. Ky dokument për shkak të ngjyrës quhet “karton i verdhë” me të cilin personave u shtyhet kthimi në shtetin amë, kurse me të cilin u ndalohet njëkohësisht qasja dhe realizimi i të gjitha të drejtave në Maqedoni, edhe pse bëhet fjalë për persona të cilët duhet të kenë mbrojtje ndërkombëtare. Avokati i Popullit nuk ka arritur të marrë përgjigje se në çfarë baze lëshohet një dokument i tillë, kur sistemi ynë juridik nuk njih një gjë të tillë. Nëse është shprehje të vullnetit, në masë më të vogël, duhet të bëhen me ligj, në këtë rast në pyetje është sundimi i të drejtës.”<sup>18</sup> Një pjesë e këtyre personave të cilët janë të mitur, u rrezikohen edhe të drejtat e fëmijës, sepse në mungesë të mjeteve financiare, prindërit e tyre nuk i paraqesin dhe këta fëmijë jetojnë në kushte të vështira jetësore. Për këtë, Avokati i Popullit theksoi se ka reaguar te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe te Ministria për Punë të Brendshme, por nuk ka përgjigje nga to.<sup>19</sup>

### Diskriminimi

Në faqen e Fejsbukut të Iniciativës “Prindëri e përbashkët dhe përgjegjëse edhe pas ndarjes” ku shumica e anëtarëve janë baballarë të vetëm, u shfaqën përmbajtje të cilat i diskriminuan dhe i shqetësuan nënat e vetme, duke i treguar ato si “të hendikepuara, tragjike dhe prindër egocentrikë, prindër që luftojnë për ‘për disa të drejta gjinore’, prindër të cilët ua shkurtojnë të drejtat fëmijëve të vet, madje edhe prindër të cilët i kanë kidnapuar fëmijët e vet, duke përfshirë edhe shpifjen se ndahen nga bashkëshortët me qëllimin e vetëm që të fitojnë dobi financiare dhe me qëllim që të hyjnë në lidhje të reja romantike.” Shumica e anëtarëve të atij grupi, nëna të vetme reagues për përmbajtjet e tilla, për shkak të diskriminimit ndaj tyre, dhe në bazë të seksit, statusit martesor dhe statusit social. “Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi dhe Organizata qytetare për përparim të të drejtave të familjeve me një prind “Një mundet” shprehin shqetësim serioz për fushatën shqetësuese të iniciativës “Prindëri e përbashkët dhe përgjegjëse edhe pas ndarjes”, sidomos kur këto aktivitete në rrjetet sociale “dhe mesazhet e tilla vetëm se e stimulojnë praninë e stigmatizimit dhe të diskriminimit të një prej kategorive më të lëndueshme të grave në shoqëri – nëna të vetme.”<sup>20</sup> Siç informuan nga Rrjeti i “Një mundet”, nëse nuk ndalojnë me shkrimin dhe shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje, përkatësisht heqjen e saj nga ky grup në Fejsbuk, do të iniciojnë procedura për përcaktim të diskriminimit para organeve kompetente.

<sup>18</sup> <http://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/nad-150-begaltsi-od-kosovo-18-godini-zhiveat-kako-fantomi-vo-makedonija/>

<sup>19</sup> <http://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/detsa-fantomi-vo-sudskite-baraki-vo-butel-vlastite-ne-sakaat-da-zboruvaat-za-niv/>

<sup>20</sup> <http://mhc.org.mk/announcements/588#.WTa8lGh97IU>

